



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1655/1 Prot.

Tiranë, më 26 / 11 / 2018

V E N D I M

Nr. 236 , Datë 26 / 11 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.96 Regj., datë 28.06.2018, në emër të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH), si përfaqësues ligjor¹ i një grupi personash, banorë të lagjes “Kastriot”, Njësia Administrative Fushë-Krujë; kundër Bashkisë Krujë, me pretendim diskriminimin për shkak të racës dhe të gjendjes sociale të tyre.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Përmes ankesës së sjellë pranë Zyrës së Komisionerit, KSHH-ja ka përcjellë shqetësimet e banorëve të kësaj lagjeje, të cilët, pjesa më e madhe i përkasin komunitetit rom (rreth 250 familje), të cilët jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Në ankesën e tyre bëhen prezente dy problematika:

Së pari, mungesa e ujit të pijshëm prej më shumë se 10 vitesh në këtë lagje. Me përjashtim të 6-7 familjeve të vendosura në fillim të lagjes, pjesa tjetër e banorëve nuk kanë ujë të pijshëm si rezultat i mungesës së rrjetit shpërndarës të ujit të pijshëm, që duhet të sigurohet nga Bashkia Krujë. Të ndodhur në këto kushte, banorët janë detyruar të sigurojnë ujin përmes shpimeve apo puseve në oborret e shtëpive të tyre; por uji është i pa kontrolluar dhe në shumicën e rasteve ka shkaktuar sëmundje tek banorët. Banorët shprehen se: *“Ujin që nxjerrim nga puset e përdorim si ujë të pijshëm, për larje apo për plotësimin e nevojave familjare. Për shkak të afërsisë të lumit Zezë me*

¹ Me kërkesë të datës 23.01.2018, firmosur nga 13 banorë të komunitetit të lagjes “Kastrioti”, Fushë-Krujë.

shtëpitë tona, uji i puseve përzihet me ujin e lumit duke e ndotur edhe më tepër, gjë që ka pasoja të dëmshme për shëndetin tonë. Nismat e mëparshme për sigurimin e ujit të pijshëm të ndërmarra nga organizata joqeveritare kanë qenë të përkohshme dhe jo afatgjata për plotësimin e nevojës me ujë të pijshëm, ndërsa Bashkia Krujë nuk ka ndërmarrë asnjë investim serioz për të zgjidhur problemin e ujit të pijshëm në lagjen tonë. Nëse Bashkia do të siguronte ujin për ne, atëherë ne do të paguajmë detyrmet financiare për ujin e konsumuar”.

Së dyti, problematika tjetër lidhet me kanalizimet e ujërave të bardha dhe atyre të zeza. Banorët shprehen se: “Ujërat e zeza kalojnë përmes disa tubave të ngushtë nëntokësorë të cilët shpesh bllokohen duke dalë në sipërfaqe afër shtëpive të banimit. Kjo shkakton një mungesë të theksuar higjens. Rrjeti i kanalizimeve është i amortizuar dhe ka nevojë për ndërhyrje të specializuara nga ana e organeve përgjegjëse shtetërore”.

Subjektet ankues shprehen se, mungesa e ujit të pijshëm, përdorimi i ujit të pakontrolluar si dhe mungesa e higjens për shkak të rrjetit të amortizuar të tubave që shkarkojnë ujërat e zeza dhe të bardha të lagjes “Kastriot”, përbën rrezik për jetën dhe shëndetin e banorëve dhe njëherësh shkel të drejtën e tyre për një jetë të shëndetshme duke cënuar dhe dinjitetin e tyre.

Në përfundim të ankesës së tyre, banorët e lagjes “Kastriot” kërkojnë nga ana e Bashkisë Krujë të marrë masat e nevojshme për të garantuar që dhe ata si banorët e lagjeve të tjera jo rome, të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa dallim e diskriminim për shkak të racës së tyre.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

²Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me nr.927/2 prot., datë 10.07.2018 i është kërkuar informacion Bashkisë Krujë, lidhur me pretendimin e KSHH-së, për problematikën e banorëve të lagjes “Kastriot”, Njësia Administrative Fushë-Krujë.

Me shkresën me nr.977/1 prot., datë 16.08.2018, Njësia Administrative Fushë-Krujë, pranë Bashkisë Krujë ka informuar Komisionerin se: “...lidhur me problematikën e banorëve të kësaj lagjeje, ne si Sektor i Shërbimeve të kësaj njësie, jemi munduar të jemi të gatshëm në çdo kohë për të zgjidhur këtë problematikë dhe këtij komuniteti ne i kemi dhënë prioritet pa i paragjykuar asnjëherë për racën apo gjendjen sociale. Sa i takon dy problematikave që kanë parashtruar banorët e kësaj lagjeje, ju bëjmë me dije se uji nuk varet nga Njësia Administrative Fushë-Krujë, por mund t’i drejtohen Drejtorisë së Ujësjellësit. Ndërsa sa i përket problemit që lidhet me kanalizimet e ujërave të bardha dhe atyre të zeza, ju informojmë se kolektori është ndërtuar shumë vite më parë dhe jo i përmasave për të përballuar prurjet e shumta të ujërave të shiut. Megjithë vështirësitë që kemi hasur, jemi përpjekur që këtë kolektor ta mirëmbajmë dhe të mos krijojmë problem me bllokimin”.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes së paraqitur nga KSHH-ja, Komisioneri me datë 28.09.2018 realizoi një seancë dëgjimore³.

Në seancë nuk u paraqitën asnjëra nga palët në proces, megjithëse referuar lajmërimit nga Posta Shqiptare, me Lajmërim marrje me kod postar : RR 094 585 388 AA dhe RR 094 585 405 AA, rezulton që ata kanë marrë dijeni për zhvillimin e saj.

Me shkresën me nr.760 prot., datë 09.10.2018 KSHH-ja ka dërguar parashtrimet e veta lidhur me problematikën e banorëve të lagjes “Kastriot”, duke cituar dhe shkeljet ligjore që sipas tyre çënojnë të drejtën e këtij komuniteti për një jetesë normale dhe dinjitoze, krahasuar me lagjet e tjera të bashkisë Krujë, në të cilat banojnë komunitet jo rom.

³Në zbatim të Njoftimit me nr.927/4 prot., datë 20.09.2018, të Komisionerit.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezulton se, është fakt i provuar dhe i pranuar nga të dyja palët në proces që:

Së pari, në këtë lagje ka mungesë të ujit të pijshëm prej shumë vitesh dhe ende nuk është gjetur zgjidhja e duhur nga ana e Bashkisë Krujë. Banorët janë detyruar të sigurojnë ujin përmes shpimeve apo puseve në oborret e shtëpive të tyre. Bashkia Krujë përgjegjësinë për mungesën e ujit të pijshëm ia kalon Ujësjellës Kanalizimeve sh.a Krujë.

Së dyti, problematika e mosfunksionimit të kolektorit të ujërave të zeza është evidente, rrjeti i kanalizimeve është i amortizuar dhe ka nevojë për ndërhyrje të specializuar nga ana e organeve përgjegjëse; fakt ky i pranuar edhe nga Bashkia Krujë, kur pohon se megjithë vështirësitë e krijuara, ata janë përpjekur ta mirëmbajnë kolektorin.

Lidhur me sa mësipër, Bashkia Krujë, si autoriteti shtetëror përkatës nuk mund të justifikojë mosveprimin e saj për furnizimin me ujë të pijshëm me argumentet që ka sjellë para Komisionerit; as përsa i takon faktit, se sipas tyre përgjegjës për ujin e pijshëm është UK-ja, dhe as përsa i takon faktit të pamundësisë ekonomike të këtij komuniteti për të realizuar pagesat e konsumit të ujit.

Banorët e kësaj lagjeje, janë komunitet rom dhe jetojnë kryesisht me ndihmë ekonomike nga shteti dhe në kushte tërësisht të papërshtatshme jetese: me mungesë të ujit të pijshëm dhe me mosfunksionim të kanalizimeve të ujërave të zeza, gjë që çon në kushtet e trajtimit johuman të këtij komuniteti. Banorët e kësaj lagjeje pretendonin që cilësia e tubave të ujit të vendosura në lagjen e tyre është e një cilësi më të dobët se tubat që furnizojnë me ujë të pijshëm lagjet e tjera të Fushë-Krujës. Ata kishin shprehur ankesën se tubacionet në lagjen e tyre ishin prej materiali plastik, ndërsa tubat e lagjeve të tjera jo rome ishin prej çeliku dhe gize.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Krujë. Pra, në këtë rast Bashkia, duhet të provonte se subjektet ankues nuk janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe më pak të favorshme se banorët e lagjeve të tjera jo rome.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur

diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Institucioni i Bashkisë Krujë, dështoi të provonte para Komisionerit se ka bërë përpjekjet e duhura dhe të domosdoshme për rregullimin e kësaj situate.

Në këto kushte, referuar informacionit të administruar, Bashkia Krujë nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion zyrtar, projekt apo plan, mbi masat që ka marrë ose që do të ndërmarrë për furnizimin me ujë të pijshëm apo lidhur me masat për ndërhyrje konkrete të rrjetit të amortizuar të tubacioneve që shkarkojnë ujërat e zeza dhe të bardha të lagjes “Kastriot”.

Në analizë të sa më sipër, mungesa e ujit të pijshëm dhe problematika e ujërave të zeza, janë fakte të njohura prej kohësh, për të cilat Bashkia Krujë nuk ka marrë asnjë masë për t’i dhënë zgjidhje kësaj situate. Mospërmbushja e detyrimeve të sanksionuara në legjislacionin shqiptar, nga ana e Bashkisë Krujë, vendos në pozita të pabarabarta ankuesit me banorë të tjerë të kësaj njësie administrative, lidhur me mosmarrjen e masave të duhura për përmirësimin e kushteve të jetesës.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁴ te ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Per mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

⁴ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se subjektet ankues mbartin shkaqet e pretenduara; atë të racës dhe të gjendjes shoqërore. Subjektet ankues, banorët e lagjes “Kastriot”, Njësia Administrative Fushë-Krujë, pretendojnë se janë trajtuar në mënyrë diskriminuese, nga ana e Bashkisë Krujë, përmes mosveprimit të tyre për të zgjidhur dhe përmirësuar situatën e tyre; pikërisht për shkaqet sipërcituar.

“Gjendja shoqërore dhe raca” janë shkaqe, për të cilat Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Shkaqet e origjinës sociale, lindjes dhe pronës paraqiten në Nenin 2(2) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e vitit 1966. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përgjegjës për monitorimin dhe interpretimin e traktatit e ka zgjeruar kuptimin e tyre në Komentin e tij të Përgjithshëm 20. Sipas Komitetit, statutet e “origjinës sociale”, “lindjes” dhe “pronës” janë të lidhura. Origjina sociale “tregon statusin social të trashëguar të individit”. Mund të lidhet me pozitën që kanë përfituar me lindjen në një komunitet ose klasë shoqërore të caktuar (si p.sh. përkatësia etnike, besimi fetar, ose ideologjia), ose nga situata shoqërore si p.sh. varfëria ose të qenurit i pastrehë. Shkaku i pronës mund të lidhet me statusin e dikujt në lidhje me tokën (si të qenit një qiramarrës, pronar ose banues i paligjshëm), ose në lidhje me pronën e të tjerëve.⁵

A. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj subjekteve ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Krujë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkaqeve të pretenduara nga ankuesit, sipas parashikimeve të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁶ dhe trajtimit të pafavorshëm të tyre.

⁵ Marrë në https://ëëë.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_laë_ENG.pdf

⁶ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Krujë⁷, ishte në dijeni të problematikave të ngritura nga KSHH-ja në emër të banorëve të e lagjes “Kastriot”, të Njesisë Administrative Fushë-Krujë; dhe se kishte dështuar deri më tani të ndërmerre masa për përmirësimin apo rregullimin e situatës, e cila pranohet edhe prej tyre.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta⁸ si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Dinjiteti i njeriut është një vlerë themelore kushtetuese⁹. Një shoqëri demokratike, që bazohet në dinjitetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë individët, duhet të garantojë plotësimin e nevojave bazike jetësore për të gjithë. Çdo individ është pjesë e një komuniteti shoqëror të caktuar dhe në këtë kontekst interpretohet edhe dinjiteti i njeriut, si një garanci themelore.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij.

Neni 14, i KEDNJ, “Ndalimi i diskriminimit”, përcakton se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si*

⁷ Referuar shkresës me nr. me nr.977/1 prot., datë 16.08.2018 drejtuar Komisionerit.

⁸ Neni 18 i Kushtetutës ka sanksionuar se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”*.

⁹Në Preambulën e Kushtetutës deklarohej: *“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”*.

seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë¹⁰, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: “...kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme...”.

Në interpretim të çështjes së sipërcituar, GJEDNJ përcakton se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm¹¹ dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe të personave në situata të ndryshme.

GJEDNJ-ja në disa raste ka konkluduar se kushtet e mjerueshme të jetesës mund të konsiderohen si trajtim çnjerëzor dhe degradues¹². Gjykata është shprehur se mungesa e aksesit për ujë të pijshëm dhe higjenë çon në trajtim çnjerëzor dhe degradues të njeriut.

Referuar rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/292, datë 28 korrik 2010, në të cilën Asambleja njohu të drejtën për ujë të pijshëm të pastër dhe të sigurt dhe për kanalizime si një të drejtë të njeriut, e cila është thelbësore për gezimin e plotë të jetës dhe të të gjitha të drejtave të njeriut, theksohet se uji i pastër dhe kanalizimet janë esenciale në realizimin e të gjitha të drejtave të njeriut. Kjo rezolutë shton trysninë mbi përgjegjësinë politike të shteteve për t'u garantuar qytetarëve të drejtën elementare për ujë të pijshëm.

Në këtë këndvështrim, mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm, mosmarrja e masave për rregullimin dhe sistemimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, apo lejimi i përdorimit të puseve të pakontrolluara për të siguruar mbulimin e nevojave minimale për ujë, nga ana e Bashkisë Krujë, u ka rrezikuar shëndetin këtyre banorëve dhe i ka vënë në kushtet e një trajtimi të papërshtatshëm dhe degradues. Vazhdimi i kësaj situatë për katër vite rresht pa ndërmarë asnjë masë rregulluese, provon se Bashkia Krujë përmes mosveprimit të saj, ka neglizhuar të përmbushë detyrimet ligjore që parashikojnë aktet përkatëse.

Referuar nenit 23, pikat 1 dhe 2, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku përcaktohen funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, vërejmë se

¹⁰Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

¹¹Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹²Çështja “Neshkov dhe të tjerë kundër Bullgarisë” dhe “Jordan Petrov kundër Bullgarisë” dhe “Halil Adem kundër Bullgarisë”.

bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.; si dhe mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Referuar nenit 23, pika 4, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku përcaktohen funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, vërejmë se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për prodhimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.

Nuk mund të pretendohet se është përmbushur detyrimi ligjor për furnizimin me ujë të pijshëm vetëm për faktin se ekziston rrjeti fizik i linjave të ujit. Furnizimi me ujë nuk përfshin vetëm ekzistencën e rrjetit fizik të furnizimit me ujë, por aksesin e qytetarëve në ujën e pijshëm; në mënyrë të mjaftueshme dhe të vazhdueshme, si për përdorimin personal, ashtu edhe për atë shtëpiak. Pikërisht fakti i ekzistencës së linjave të ujit të pijshëm në lagjen Rome dhe mosfurnizimi në mënyrë efektive me ujë të pijshëm provon diskriminimin e këtij komuniteti përmes mohimit të aksesit në ujën e pijshëm.

Kuadri ligjor ka mirëpërcaktuar se është detyrë e përgjegjësi e UK-së (që është në varësi të pushtetit vendor) të sigurojë furnizimin me ujë të pijshëm dhe të shëndetshëm. UK ka detyrim të shtrojë linjat e furnizimit, të vendosë matës në familjet konsumatore dhe të bëjë furnizimin me ujë të pijshëm.

Lidhur me sa mësipër, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore i KB (CESCR), kërkon që shtetet të angazhohen për ngritjen e sistemeve për shpërndarjen e ujit, që shmangin përjashtimin e grupeve të caktuara të popullsisë, e veçanërisht ato grupe të mbrojtura nga parimet e mosdiskriminimit.

Sipas CESCR-së: *“Shtetet palë duhet të ndërmarrin hapa për të eliminuar “de facto” diskriminimin për shkaqet e ndaluara në ligj, ku individët apo grupet e personave nuk duhet të jenë të privuara nga mjetet apo të drejtat për të siguruar të drejtën e ujit. Shtetet palë duhet të sigurojnë që, shpërndarja e burimeve të ujit dhe investimet për ujën të lehtësojnë aksesin tek uji për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Duke respektuar të drejtën për ujë, Shtetet palë kanë detyrimin e posaçëm për t’u siguruar atyre që nuk kanë, ujën e pijshëm si dhe për të parandaluar çdo diskriminim për shkaqet e ndaluara dhe të njohura në të drejtën ndërkombëtare lidhur me sigurimin e ujit të pijshëm dhe të shërbimeve të ujit”.*

Lidhur me sa mësipër, komunitetit rom të lagjes “Kastriot”, Njësia Administrative Fushë-Krujë, i është mohuar e drejta e aksesit në furnizimin me ujë të pijshëm si dhe përsa i përket kushteve të

higjenës si pasojë e mos marrjes të masave për rregullimin e tubacioneve të ujërave të zeza. Mungesa e ujit të pijshëm dhe higjenës nxit stigmën ndaj tyre duke i përjashtuar nga shoqëria, gjë që për pasojë sjell dhe diskriminim të tyre.

Bazuar në informacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe faktin që gjendja pranohet nga të dyja palët në proces; konstatohet që gjendja e këtyre banorëve vijon të mbetet e pa zgjidhur. Nga ana e Bashkisë Krujë, nuk është paraqitur asnjë provë, argument apo fakt i dokumentuar, që do të justifikojë mosmarrjen e masave për sigurimin e ujit të pijshëm, apo ndërhyrjen konkrete për përmirësimin në sistemin e ujërave të zeza.

Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, mosveprimet nga ana e Strukturave të Bashkisë Krujë, në dëm të ankuesve, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tyre në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke i vënë në pozita diskriminuese për shkak të gjendjes ekonomike dhe sociale.

Neni 3 i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka përcaktuar se: *“Diskriminim i drejtëpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.*

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1¹³, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se ankuesit, janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e Strukturave të Bashkisë Krujë, trajtim i cili ka lidhje të drejtëpërdrejtë, me gjendjen ekonomiko-sociale të tyre.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 12, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

¹³Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës dhe gjendjes shoqërore, të banorëve të lagjes “Kastriot”, Njësia Administrative Fushë-Krujë , nga ana e Bashkisë Krujë.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme për rregullimin e problematikës së këtyre banorëve nga ana e Bashkisë Krujë.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Bashkia Krujë, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Shërbime

Shkaku: Raca, Gjendja Shoqërore